

Refki Morina, zëdhënës i deritanishëm i SHPK-së, është larguar nga detyra

Zëdhënësi - kufitar

Ish-zëdhënësi Morina, që "rrëshqiti" kur foli për homoseksualët, nuk mund të thuhet se është ndëshkuar, pasi ai, pas trajnimit në Shkollën e Policisë në Vushtrri, avancohet në major të SHPK-së dhe do t'i bashkëngjitet policisë kufitare

VALMIR KLAIQI
Prishtinë, 30 janar - Tash e dy javë Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) nuk ka zëdhënës të përgjithshëm për informim. Në SHPK ende nuk është hapur konkurs i ri për zëdhënës. Sipas zyrtares për informim Violeta Elezaj nuk dihet se kur do të hapet konkursi. "Ne si zyrtarë në zyrën e informimit, do t'i krye-

jmë detyrat e zëdhënësit deri sa të zgjidhet ai". Zëdhënësi i deritanishëm i SHPK-së Refki Morina, së bashku me një grup të togerëve, kanë shkuar në një trajnim në shkollën policore në Vushtrri. Ky trajnim do të vazhdojë për pesë javë rresht. Një nga zëdhënësit e SHPK-së Sabrie Kamberi, tha se ky trajnim i Morinës nuk ka të bëjë me vërejtjet e komisarit të policisë Kai Vittrup, për gabimin e tij, disa ditë

më parë, ku me rastin e keqtrajtimin të dy homoseksualeve nga ana e dy policëve, Morina ka deklaruar për media se, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, pjesëtarët e SHPK-së kanë të drejtë të arrestojnë të dyshuarit për homoseksualizëm duke e trajtuar si vepër kundërvajtëse. Për këtë gabim të tij, komisar Vittrup ka kërkuar falje publike dhe brenda javës së kaluar ka marrë masa

disiplinore, ka suspenduar me pagesë dhjetë policë të SHPK-së. Sipas Kamberit, Morina pasi ta përfundojë trajnimin në Vushtrri, do të gradohet në major të SHPK-së". Morina, sipas Kamberit, nuk do të punojë më si zëdhënës i SHPK-së, por do të marrë një detyrë tjetër. Nga ana tjetër, Refki Morina i pyetur nga "Lajm" për detyrën e tij të deritanishme dhe për

detyrën e ardhshme, nuk deshi të flasë. "Nuk dua të flas për media, thirr në zyrën për informim, ata të tregojnë për mua". Një burim i "Lajm"-it brenda SHPK-së tha se Morina pasi ta kryejë trajnimin në Vushtrri, do të angazhohet në policinë kufitare. Kriter kryesor për t'u bërë zëdhënës i SHPK-së është që grada e policit të jetë minimum rreshter. Duhet të jetë orator i mirë, i hapur, t'i njohë ligjet dhe etikën.